



Datë: 19.05.2025
Numër Protokolli: 3296/2025

A.nr.592/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.592/2025, të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi M.K., kundër organit të punësimit: Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim më datë 19.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.592/2025, e datës 03.04.2025, e parashtruar nga ankuesi, M.K.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli Nr.8815/25 i datës 26.02.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit si dhe Njoftimi me numër Nr.11765/25 i datës 19.03.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016336, për Grupin e Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes së të Ardhurave, pozita Zyrtar për Tatim në Pronë.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil M.K. (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesi*), përmes Postës së Kosovës, më datë 28.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 03.04.2025, nën shenjë A.nr.592/2025, kundër Vendimit me numër protokolli 8815/25 të datës 26.02.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference: RN00016336, për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vushtrrisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë. *Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova:* Ankesën me numër protokollit 2211/2025 të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës së datës 03.04.2025; Pliko nga posta e Kosovës e datës 28.03.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 22.04.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Konkursin me numër reference RN00016336, të datës 15.01.2025; Shkresën e datës 09.01.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin me numër 8815/25 të datës 26.02.2025; Njoftimin për verifikimin paraprak të datës 27.02.2025; Vendimin me numër protokollit 218/2025 të datës 27.02.2025; Akt emërimit AE.nr.20-035/02-0033822/22 të datës 30.06.2022; Akt emërimit Nr.322/14 të datës 10.03.2014; Akt emërimit Nr.60241/24 të datës 20.12.2024; Akt emërimit Nr.10201/25 të datës 07.03.2025; Akt emërimit Nr.37442/24 të datës 01.08.2024; Njoftimin për test me shkrim të datës 12.03.2025; Rezultatet e testit me shkrim; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 19.03.2025; Njoftimin përfundimtar me Nr. 11765/25 të datës 19.03.2025; Testet me shkrim të kandidatëve fitues; Aplikacionin me datë të aplikimit 17.01.2025, të kandidatit M.K së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë të aplikimit 22.01.2025, të kandidatit E.J së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë të aplikimit 22.01.2025, të kandidatës G.H së bashku me dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të dorëzuara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Vushtrrisë, më datë 15.01.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016336, për Grupin e Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes së të Ardhurave, respektivisht për pozitën Zyrtar për Tatim në Pronë, me klasë të pozitës Profesional 2, dy (2) vende të lira pune, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa/Spektori i Tatimit në Pronë, i hapur për aplikim nga data 16.01.2025 deri më datën 14.02.2025.

Rrjedhimisht, në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar 58 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit sipas Vendimit me numër protokollit Nr.8815/25 të datës 26.02.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se: *Nuk i ka plotësuar kriteret sipas pikës 2 të konkursit, pasi që i njëjti nuk ka bashkangjitur dëshmi me të cilën vërtetohet përvoja e punës së paku një (1) vit pas diplomimit në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, më datë 19.03.2025 ka publikuar Njoftimin me numër prot.11765/25, për rezultatet përfundimtare të vlerësimit, nga rezulton se si kandidatë të suksesshëm për procedurën përkatëse janë shpallur: G.H. më 91 pikë, E.J. më 86.80 pikë, A.S. më 81.80 pikë dhe T.S.U. më 81.20 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli Nr.8815/25 të datës 26.02.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë lidhur me refuzimin e aplikacionit, duke pretenduar se ka përvojën e mjaftueshme për pozitën përkatëse dhe atë nga 15.06.2023 deri 15.12.2023 ka shërbyer në Agjencinë e Punësimit në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe prej datës 01.08.2024 deri më datë 16.01.2025 në Komunën e Vushtrrisë në Drejtorisë e Financave, kështu që ky vendim mbi bazë të këtyre fakteve përbënë shkelje ligjore. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të vendimi i kontestuar të anulohet në tërësi.

Kolegji i Këshilli, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen konkursit publik me numër reference RN00016336, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm të Tatim Taksave apo mbledhjes së të Ardhurave, respektivisht për pozitën e punës *“Zyrtar për Tatim në Pronë”* në Komunën e Vushtrrisë, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Drejtimi Juridik/Ekonomik; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.** dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj se kriteret e përgjithshme për pozitën përkatëse të punës kane qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohej se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj”,* si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: 2. *Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Tutje, Kolegji i Këshillit i`u referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë nenit 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar prapë prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”.

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit të kundërshtuar me ankesë në ndërlidhje me provat me provat materiale të kësaj çështje, nga si pasojë e analizimit ka ardhur në konstatimin së ankuesi më datë 17.01.2025 ka aplikuar në konkursin numër reference RN00016336 dhe sipas aplikacionit të dorëzuar me dokumentacionin përcjellës (dokumentacion i dorëzuar në përgjigjen në ankesë), rezulton se i njëjti posedon Diplomën Nr.D-701/19 të datës 21.10.2019, më të cilën dëshmohet se më datë 16.09.2019, ka përfunduar studimet themelore në Programin Ekonomik, Kolegji ISPE. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës, posedon Marrëveshjen me Nr. 144/I të datës 15.06.2023, më Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, për Angazhim në Praktikë në Punë, në kuadër të Agjencisë së Statistikave të Kosovës si dhe Aneks Marrëveshjen 06-606-2023, të datës 02.06.2023, për angazhim në masën aktive të tregut të punës-praktikë në punës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, prej datës 15.05.2023 deri më datë 15.11.2023 (6 muaj), ndërsa, ankuesi nuk ka bashkangjitur ndonjë dokument tjetër të përvojës së punës. Në fakt, lidhur me dokumentin që pretendon ankuesi se ka përvojën e punës prej datës 01.08.2024 deri më datë 16.01.2025 në Komunën e Vushtrrisë në Drejtorinë e Financave, Kolegji i Këshillit, nuk ka arritur të konstatoi së ankuesi këtë dokument e ka dorëzuar me rastin e aplikimit, por të njëjtin e ka dorëzuar me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve rezulton së ankuesi nuk ka ofruar dëshmi më rastin e aplikimit që argumentojnë përvojën e punës prej një (1) vit, siç kërkohej me konkursin përkatës, kështu që, si rrjedhojë ,Vendimi me numër protokolli Nr.8815/25 i datës 26.02.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, për refuzimin e aplikacionit të ankuesit, është nxjerr në pajtim më nenin nenit 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe 2.3 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj, pretendimet ankimore janë të papabazuara.

Në kuptim të të gjeturave si më lart, Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, si njësi përgjegjëse në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, ngase ka refuzuar aplikacionin vetëm pas konstatimit se ankuesi nuk ka dorëzuar aplikacionin e kompletuar me dokumentet e kërkuara sikurse parashihej në konkurs, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e ligjit material.

Duke marr parasysh që procedura e pranimit ka përfunduar me kandidatë fitues, Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor të KPMSHCK-së lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit numër reference RN00016336, për Grupin e Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes së të Ardhurave, respektivisht për pozitën Zyrtar për Tatim në Pronë, dhe si rrjedhojë nuk ka gjetur shkelje esenciale ligjore të cilat si të tilla procedurën përkatëse të pranimit do ta bënin në tërësinë e saj të paligjshme.

Gjegjësisht, Kolegji në vështrim të parimit të meritokracisë si një nga primet bazë për pranim në shërbim civil, ka shqyrtuar dosjet e kandidateve me më shumë pikë dhe si rrjedhojë ka gjetur këtë gjendje të fakteve:

-Kandidatja G.H. posedon Diplomën Nr.9441, të datës 25.09.2018, me të cilën dëshmohet se më datë 14.09.2018, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marrë titullin Bachelor për Menaxhment dhe Informatikë. Ndërsa, përkritazi me përvojën e punë ka bashkangjitur, Vërtetimin e datës 15.01.2020, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me të cilën dëshmohet se ka qenë e angazhuar në pozitën praktikante nga data 03.01.2019 deri më datën 31.12.2019.

-Kandidati E.J. posedon Diplomën Nr.153, të datës 04.02.2021, me të cilën dëshmohet se më datë 20.01.2021, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marrë titullin Bachelor i Shkencave në Banka Financa dhe Kontabilitet. Ndërsa, përkritazi me përvojën e punës kandidati posedon: Vërtetimin e datës 03.01.2025, të lëshuar nga Drejtori i Kompanisë NTSH “Sunguri “Vushtrri, me të cilën vërtetohet se ka mbajtur pozitën e punës “Zyrtar Financiar” nga data 01.04.2023 deri më datën 31.12.2024, ndërsa, nga Pasqyra e Turistit për pagesën e kontributeve pensionale, rrjedh së kandidati ka punuar pran kësaj kompanie për periodën kohore prill-dhjetor 2023 (9 muaj) dhe janar-qershor 2024 (6 muaj), pra, përvoja e punës në këtë kompani është 1 vit e 2 muaj.

Pra, mbi faktet e analizuar si më lart, del së kandidatet G.H. dhe E.J. kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale, e duke qenë se të njëjtit kanë arritur numrin më të madh të pikëve, atëherë, me të drejtë Divizioni i Burimeve Njerëzore i organit të punësimit ka shpallur rezultatet e vlerësimit përfundimtar për kandidatët e suksesshëm, në procedurën e pranimit më numër reference RN00016336, në pajtim më përcaktimet sipas nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Duke qenë së në procedurën e kontestuar nuk është evidentuar ndonjë shkelje procedurale apo materiale dhe po ashtu nuk është konstatuar ndonjë cenim i të drejtave të ankuesit në raport me të drejtën për aplikim, dhe për rrjedhojë, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit procedura e pranimi sipas konkursit me numër të referencës RN00016336, është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil.

Për sa më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.592/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, M.K.;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.